



FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve janë të interesuar për: **Hapësirë/ Sallë dhe akomodim** për organizimin e aktiviteteve për ngritje të kapaciteteve të profesionistëve të parapara në kuadër të projektit regjional “Fuqizimi dhe aftësimi të rinjëve përmes mundësive të reja – YEEP2”, projekt ky i cili zbatohet në Maqedoninë Veriore, Shqipëri, Bosne dhe Hercegovinë, Serbi dhe në Kosovë nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimor - BMZ dhe Fondit Hermann Gmeiner Gjermani – HGFD dhe ka për qëllim të permirësojë mundësitë për punësim dhe pjesëmarrje aktive të të rinjëve në rrezik në tregun e punës.

Aktivitetet planifikohet të organizohen në qytetin e Pejës ose Bogë gjatë periudhës së implementimit të projektit: Nëntor 2023 deri Nëntor 2026. Gjatë kësaj periudhe kohore do të organizohen përafërsisht 16 aktivitete/ trajnime/ punëtori me akomodim me rreth 25 pjesëmarrës

Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë në përputhje me specifikat e cekura më poshtë:

Për punëtoritë në fjalë duhet të përfshihen:

- Akomodimi me mëngjes në dhoma teke
- 3 shishe ujë dhe 3 kafe gjatë punëtorisë
- Dreka (supë, sallatë, pjatë kryesore, ëmbësirë) me një pije joalkoolike
- Darka (supë, sallatë, pjatë kryesore, ëmbësirë) me një pije joalkoolike
- Salla për punëtori me hapësirë të mjaftueshme për punë dhe aktivitete për përafërsisht 25 pjesëmarrës, të ketë projector, tabelë flipchart, lidhje stabile interneti, mundësi printimi. Salla duhet të jetë e klimatizuar dhe të ketë ndriqim dhe qetësi

Oferta financiare duhet të jetë e specifikuar me cmime të ndara për:

1. Akomodimi me mëngjes për person
2. Dreka me një pije joalkoolike për person (të bashkangjitet menyuja)
3. Darka me një pije joalkoolike për person (të bashkangjitet menyuja)
4. 1 Kafe
5. 1 Shishe e vogël ujë
6. 1 Caj
7. 1 pije joalkoolike
8. Salla për një ditë pune

Ofertuesit së bashku me ofertën duhet të dorëzojë:

1. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit/ NUI
2. Çmimet duhet të kuotohen në euro pa TVSH
3. Çmimet për njësi sipas specifikacionit
4. Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur /apo me logo zyrtare

Oferta juaj duhet të jetë e vlefshme 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë

Ofertuesi i përzgjedhur duhet të paraqesë Vërtetimin Tatimor

Kriteret për përzgjedhje:

- Përbushja e specifikacionit sipas kërkesës sonë;
- Pas plotësimit të kriterëve të lartëpërmendura , çmimi më i lirë

Ofertat tuaja mund t’i dërgoni deri me datën: **16.11.2023** në email adresën:
procurement1@soskosova.org